



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.771/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.12.2017 shqyrtoi ankesën me: _____

Objekt:

Modifikimi i dokumentave si dhe anulimi i procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-30565-10-20-2017 me objekt: “Blerje Set të Urgjencës Mjekësore”, me fond limit 39,644,828.00 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 21.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

Public Health Sector

Ankimues:

“Almedical” shpk
Rruga “Konferenca e Pezës”, banesa nr.1, ish magazinat e ESKUT Tiranë.

Autoriteti Kontraktor

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
Rruga Lord Bajron, Nr.70, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.10.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-30565-10-20-2017 me objekt: “Blerje Set të Urgjencës Mjekësore”, me fond limit 39,644,828.00 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 21.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

II.2. Në datën 08.11.2017 autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën mbi modifikimin e dokumentave të tenderit.

II.3. Në datën 14.11.2017 operatori ekonomik “Almedical” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- Në datën 09.11.2017 autoriteti kontraktor ka bërë modifikime tek kriteret dhe tek specifikimet teknike si më poshtë:

1. Tek kriteret e vecanta për kualifikim 2.3 pika 2 për kapacitetet teknike:

Ishte: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar, per artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.

- Bëhet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqip.

E gjykojmë tërësisht diskriminuese për një sërë kompanish faktin që kjo pikë të mbetet vetëm autorizim prodhuesi dhe të hiqet pjesa dhe/ose autorizim distributori . Procedura në rastin konkret është një procedurë blerje dhe jo shërbimi gjë që edhe autorizimi i distributorit mund të garantojë AK se mallrat mund të ofertohen nga distributori zyrtar drejt operatorit ekonomik e ky dokument i fundit është mëse i mjaftueshëm për të siguruar dhe garantuar autoritetin kontrktor për ofertimin e zërave të kërkuar. Kjo kërkesë e AK nga mënyra se si është shkruar është e tepërt dhe në kundërshtim me parimet kryesore të LPP.

- Tek shtojca 10 “Specifikimet Teknike” shumë artikuj të listës kanë pësuar ndryshime themelore në emërtim dhe në specifikim teknik gjë që sjell në mënyrë të drejtpërdrejtë ndryshime themelore në produkte dhe në cmimet e ofertuara nga operatori ekonomik . Ndryshimet e bëra vijnë si më poshtë:
- Nr.19 Lama. Shtohet fjalia tek specifikimet teknike të jetë adulte dhe pediatrike dhe numri i lamave rritet .
- Nr.25 Letër EKG. Është shtuar specifikimi të jetë e paloshme me 100 fletë dhe e përshtatshme për defimonitor EVO gjë që sjell përcaktim të një lloji tjetër letre EKG dhe aparature duke mos vendosur pjesën ose ekuivalente.
- Nr.26 Ngjitëse për elektrodën është shtuar specifikimi Të jenë me diametër 55 mm me përmbajtje Ag/agCl Xhel me klikim. Të jetë e përputhshme për defimonitor EVO gjë që sjell përcaktimin e një lloji tjetër ngjitëse elektrofash dhe për aparaturë të përcaktuar duke mos vendosur pjesën ose ekuivalent.
- Nr.27 Pjastra Pediatrike gjë që sjell ndryshimi në llojin e pjastrave dhe është përcaktuar lloji i modeleve të aparaturave në funksion të një aparature të përcaktuar pa vënë pjesën ose ekuivalent. Të kryejë funksionin e defibrilimit dhe pacemakerit një perdimshme adezive dhe me diagramë për vendosje të qartë. Të jetë e përputhshme për defimonitor Evo. Të jetë për përdorim pediatrik. Të jetë e përputhshme për Rescue Sam Aed.
- Nr.28 Pjastra (adulte) gjë që sjell ndryshim në llojin e pjastrave dhe është përcaktuar lloji i modeleve të aparaturave në funksion të një aparature të përcaktuar pa vënë pjesën ose ekuivalent. Të kryejë funksionin e defibrilimit dhe pacemakerit një perdimshme adezive dhe me diagramë për vendosje të qartë. Të jetë e përputhshme për defimonitor Evo. Të jetë për përdorim pediatrik. Të jetë e përputhshme për Rescue Sam Aed.
- Nr.38 Rregullues fluksi plastik i graduar është shtuar pjesa i graduar kjo ndryshon llojin duke rritur të dhenat e specifikimeve teknike.

- Nr.42. Paketë dezinfektimi me dezinfektantë për plagë: a)Betatide, b) Ujë i oksigjenuar. Në rastin konkret ky zë është ndryshuar tërësisht i cili sjell ndryshim cilësor dhe sasi të artikullit Betadina. Në këtë paketë është shtuar zëri betadinë nga 1000 shishe në 10.000. Në listën e mëparshme nuk ka ekzistuar kërkesa për ujë të oksigjenuar dhe ky zë është shtuar në pjesën e paketës gjë që sjell edhe 10,000 shishe shtesë.
- Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë të pambështetura në ligj dhe me shkelje pasi ndryshimet në specifikimet teknike sjellin ndryshime të cilësisë së produkteve dhe aq më tepër shtimi i zërave si uji i oksigjenuar sjell ndryshim në përlllogaritjen e fondit limit. A mundet autoriteti kontraktor të na arsyetojë se neni 42 i LPP është ligji i duhur mbi ndryshimet e specifikimeve teknike apo të kriterëve të DST?? Përse AK tek ndryshimet e bëra nuk ka bashkëngjitur edhe tabelën me ndryshim të sasive si rrjedhojë e ndryshimeve të specifikimeve teknike të bëra??
- AK në zbatim të ligjit duhet:
- 1. Të mos ndryshojë kërkesën 2.3 për paraqitjen vetëm me autorizim prodhuesi por të lërë sic e kishte më parë në DST edhe /ose autorizim distributori gjë që rrit konkurrencën dhe nuk sjell asnjë ndryshim ligjor dhe bazik për AK.
- 2. Të ndryshojë specifikimet teknike sepse në modifikimin e bërë është ndryshuar lloji i produktit dhe numrin dhe kjo sjell një shkelje të hapur ligjore dhe tërësisht të pajustificuar. Përfundimisht kërkojmë që shtesa “Shtojcë tenderi set pajisjesh mjekësore” të anulohet pasi sjell ndryshime në specifikimet teknike dhe ndryshime në sasi duke shkelur ligjin e LPP.

II.4. Në datën 15.11.2017 me shkresën nr.440 prot datë 15.11.2017 operatori ekonomik ankimues “Almedical” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës.

II.5. Në datën 20.11.2017 pala ankimuese “Almedical” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor si dhe ka kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr.452 prot., datë 23.11.2017 protokolluar me tonën me nr.1736/2 datë 23.11.2017 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” shpk për modifikimin e kriterit “Tek kriteret e vecanta për kualifikim 2.3 pika 2 për kapacitetet teknike: Ishte: Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar, per artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Bëhet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqip. E gjejkojmë tërësisht diskriminuese për një sërë kompanish faktin që kjo pikë të mbetet vetëm autorizim prodhuesi dhe të hiqet pjesa dhe/ose autorizim distributori. Procedura në rastin konkret është një procedurë blerje dhe jo shërbimi gjë që edhe autorizimi i distributorit mund të garantojë AK se mallrat mund të ofertohen nga distributori zyrtar drejt operatorit ekonomik e ky dokument i fundit është mëse i mjaftueshëm për të siguruar dhe garantuar autoritetin kontraktor për ofertimin e zërave të kërkuar. Kjo kërkesë e AK nga mënyra se si është shkruar është e tepërt dhe në kundërshtim me parimet kryesore të LPP”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën “modifikim i dokumentave të tenderit” të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike më datë 08.11.2017, ndryshohet kriteri si më poshtë:

Ishte:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar, për artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.

Bëhet:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.3. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjejkon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjeqësor. Në rastin kur

procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 27 pika 3 e VKM 914/2014 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: **dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;** që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Megjithatë KPP gjykon se modifikimi i kriterit duke hequr fjalinë autorizim nga distributori i autorizuar duke lënë vetëm dokumentin autorizim nga prodhuesi kufizon konkurrencën për ata operatorë ekonomikë që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me prodhuesin por me një apo më shumë distributor të autorizuar nga prodhuesi. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e kualifikimit lidhur me autorizimin e prodhuesit duke përfshirë në mënyrë alternative edhe autorizimin nga distributori i autorizuar nga prodhuesi me kushtin që në cdo rast të vërtetohet me dokumentacion konkret lidhja e distributorit të autorizuar me prodhuesin pasi ky dokumentacion i paraqitur në mënyrë të plotë do të vërtetonte dhe dëshmonte njësoj origjinën e mallit.

Public Health Sector

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se artikulli “Nr.19 Lama. Shtohet fjalia tek specifikimet teknike të jetë adulte dhe pediatrike dhe numri i lamave rritet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” i dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1	Set imobilizimi kollone	100 copë			
2	Set imobilizimi gjymtyrësh	70 copë			

3	Gërshërë multifunksionale	50 copë			
4	Qafore	440 copë			
5	Set imobilizimi në formën e merimangës (Spider)	110 copë			
6	Bllokues Koke	100 copë			
7	Mbulesë izotermike (Metalin)	2000 copë			
8	Mushama (telo)	100 copë			
9	Canta autoambulancës	120 copë			
10	Set i vogël cantash	500 copë			
11	Maskë mbrojtëse	100 copë			
12	Gudel	300 copë			
13	Rakord O ₂	300 copë			
14	Maskë silikoni	700 copë			
15	Maskë aerosoli	100 copë			
16	Ambu	120 copë			
17	Sfigmomanometër	100 copë			
18	Fonendoskop	100 copë			
19	Dorezë laringu	50 copë			
20	Lama	150 copë			
21	Tub ET	500 copë			
22	Mbajtëse agosh	200 copë			
23	Termometër	200 copë			
24	Glukometër	100 copë			
25	Letër EKG	1000 copë			
26	Ngjitëse për elektrodë	15000 copë			
27	Piastra adulte	50 copë			
28	Piastra pediatrike	15 copë			

29	Strisha për glukometër	10000 copë			
30	Fasho autoadezivë 10x10	2000 copë			
31	Fasho autoadezivë 10x15	2000 copë			
32	Fasho autoadezivë 10x20	2000 copë			
33	Carcafë njëpërdorimësh	30000 copë			
34	Shiringa	2000 copë			
35	Doreza	1000 copë			
36	Klema	100 copë			
37	SNG	200 copë			
38	Kateter vezikal	500 copë			
39	Lak hemostatik	500 copë			
40	Kanjula venoza	10000 copë			
41	Rregullues fluksi	2000 copë			
42	Garza pambuku	10000 copë			
43	Paketa dezinfektuese	10000 copë			
44	Defluskor	10000 copë			
45	Ngjitëse fiksatore ageve	2000 copë			
46	Bisturi 1 përdorimësh	250 copë			
47	Gërshërë të vogla	200 copë			
48	Rubinetat dhe 3 rrugë	2000 copë			
49	Betadinë	1000 copë			
50	Pulsoksimeter	100 copë			
50	Maskë oksigjeni Venturi	2000 copë			
51	Tub nazal për oksigjenim	1400 copë			
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

III.2.2. Në shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e artikujve që kërkohen:

Nr	Artikulli	Njesia	Sasia
1	Set imabilizimi kollone	Copë	100
2	Set imobilizimi gjymtyrësh	Copë	70
3	Gërshërë multifunksionale	Copë	50
4	Qafore	Copë	440
5	Set imobilizimi në formë merimange (Spider)	Copë	110
6	Bllokus koke	Copë	100
7	Mbulesë izotermike(Metalin)	Copë	2000
8	Telo Mushama	Copë	100
9	Canta e autoambulancës	Copë	120
10	Set i vogël cantash	Copë	500
11	Mask Mbrojtese	Copë	100
12	Gudel	Copë	300
13	Rakord O2	Copë	300
14	Maskë Silikoni	Copë	700
15	Maskë Aerosoli	Copë	100
16	Ambu	Copë	120
17	Sfigmomanometër	Copë	100
18	Fonendoskop	Copë	100
19	Dorezë Laringu	Copë	50
20	Lama	Copë	150
21	Tub ET	Copë	500
22	Mbajtëse agosh	Copë	200
23	Termometër	Copë	200

24	Glukometër	Copë	100
25	Letër EKG	Copë	1000
26	Ngjiteset per eletrodat	Copë	15000
27	Pjastra adulte	Copë	50
28	Pjastra pediatrike	Copë	15
29	Strisho për glukometër	Copë	10000
30	Fasho autoadezive 10x10	Copë	2000
31	Fasho autoadezive 10x15	Copë	2000
32	Fasho autoadezive 10x20	Copë	2000
33	Carcaf 1 përdorimësh	Copë	30000
34	Shiringa	Copë	2000
35	Doreza njëpërdorimëshe 6,5-7-8-8.5 kuti	Copë	1000
36	Klema plastike te kordonit umbilikal	Copë	100
37	SNG	Copë	200
38	Kateter vezikal	Copë	500
39	Lak hemostatik	Copë	500
40	Kanjula venoze	Copë	100000
41	Rregullues fluksi	Copë	2000
42	Garza pambuku	Copë	10000
43	Paketa dezinfektuese	Copë	10000
44	Defluskor	Copë	10000
45	Ngjitëse fiksatore e ageve	Copë	2000
46	Bisturi njëpërdorimëshe	Copë	250
47	Gërshërë të vogla	Copë	200
48	Rubinetat dhe 3 rrugë	Copë	2000
49	Betadinë	Copë	1000

50	Pulsoksimetër	Copë	100
51	Maskë oksigjeni Venturi	Copë	2000
52	Tub nazal për oksigjenim	Copë	1400

III.2.3. Në shtojcën “modifikim i dokumentave të tenderit”, të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike më datë 08.11.2017, ndryshohet specifikimi teknik si më poshtë:

Ishte

19. Lama



- *Të ketë formë të lakuar e cila mundëson rrëshqitjen në nivel te valekulave dhe mbajtjen hapur te rrugeve te frymëmarrëjes duke shtypur gjuhën*

Bëhet:

19- Lama



- *Të ketë formë të lakuar e cila mundëson rrëshqitjen në nivel te valekulave dhe mbajtjen hapur te rrugeve te frymëmarrëjes duke shtypur gjuhën, me masa te ndryshme*
- *Te jete adulte dhe pediatrike*

III.2.4. Në nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 5 “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar”:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

5. “Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përpuethshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse, por pa cënuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit/punës/mallit që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë.

III.2.6. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pretendim të ankimuesit sqarohet se: Në lidhje me pajisjen lama ne kemi specifikuar që të jenë adulte dhe pediatrike ndërsa sasia e tyre është e njëjtë nuk ka pësuar ndryshime sic është kërkuar në DST. Komisioni gjykon se përcaktimi në mënyrë konkrete i llojit të lamave adulte dhe pediatrike duke mos ndryshuar sasinë e tyre nuk sjell asnjë ndryshim në fondin limit të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP rezulton se modifikimet e specifikimeve teknike me anë të shtojcës së datës 08.11.2017 janë bërë nga autoriteti kontraktor në përgjigje të kërkesave të operatorëve ekonomikë për sqarime më të hollësishme dhe të detajuar lidhur me specifikimet teknike. Në këtë kuptim KPP gjykon se për sa kohë që nuk janë shtuar sasi të apo akoma më tej në specifikimet teknike nuk është parashikuar asnjë specifikë diskriminuese modifikimi i tyre nga autoriteti kontraktor është brenda kufijve të parashikuar në ligj.

KPP sqaron se autoriteti kontraktor ka të drejtë dhe detyrim njëherazi për të qënë sa më i qartë sa më konkret në përshkrimin e detajuar të specifikave që duhet të përmbushë malli objekt prokurimi në mënyrë që operatorë ekonomikë të jenë tërësisht të qartë në momentin e dorëzimit të ofertës. Në rastin konkret specifikimet lidhur me llojin e lamave që do të prokurohen nuk krijojnë asnjë pengesë të hapur apo të fshehur për operatorët ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se artikulli “Nr.25 Letër EKG. Është shtuar specifikimi të jetë e paloshme me 100 fletë dhe e përshtatshme për defimonitor EVO gjë që sjell përcaktim të një lloji tjetër letre EKG dhe aparature duke mos vendosur pjesën ose ekuivalente.

Nr.26 Ngjitëse për elektrodën është shtuar specifikimi Të jenë me diametër 55 mm me përmbajtje Ag/agCl Xhel me klikim. Të jetë e përputhshme për defimonitor EVO gjë që sjell përcaktimin e një lloji tjetër ngjitëse elektrodash dhe për aparaturë të përcaktuar duke mos vendosur pjesën ose ekuivalent.

Nr.27 Pjastra Pediatrike gjë që sjell ndryshimi në llojin e pjastrave dhe është përcaktuar lloji i modeleve të aparaturave në funksion të një aparature të përcaktuar pa vënë pjesën ose ekuivalent. Të kryejë funksionin e defibrilimit dhe pacemakerit një perdimshme adezive dhe me diagramë për vendosje të qartë. Të jetë e përputhshme për defimonitor Evo. Të jetë për përdorim pediatrik. Të jetë e përputhshme për Rescue Sam Aed.

Nr.28 Pjastra (adulte) gjë që sjell ndryshim në llojin e pjastrave dhe është përcaktuar lloji i modeleve të aparaturave në funksion të një aparature të përcaktuar pa vënë pjesën ose ekuivalent. Të kryejë funksionin e defibrilimit dhe pacemakerit një perdimshme adezive dhe me diagramë për vendosje të qartë. Të jetë e përputhshme për defimonitor Evo. Të jetë për përdorim pediatrik. Të jetë e përputhshme për Rescue Sam Aed’, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën “modifikim i dokumentave të tenderit”, të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike më datë 08.11.2017, ndryshohet specifikimi teknik si më poshtë:

Ishte:

- 1- Letër EKG
- 2- Ngjitëse për elektrodën
- 3- Pjastra (adulte dhe pediatrike)

Behet

- 25- Letër EKG
- Të jetë e paloshme me 100 flete dhe e përputhshme për defimonitor Evo
- 26- Ngjitëse për elektrodën

- Te jene me diameter 55mm me permbajtje Ag/agCl Xhel me klikim
- Të jetë e përputhshme per defimonitor Evo

27- Pjastra (pediatrike)

- Të kryejne funksionin e defibrilimit dhe pacemakerit nje perdimshme adezive dhe me diagrame per vendosje te qarte
- Të jetë e përputhshme per defimonitor Evo
- Të jetë per perdorim pediatrik
- Të jetë e përputhshme per Rescue SAM Aed

28- Pjastra (adulte)

- Të kryejne funksionin e defibrilimit dhe pacemakerit nje perdimshme adezive dhe me diagrame per vendosje te qarte
- Të jetë e përputhshme per defimonitor Evo
- Të jetë per perdorim adult
- Të jetë e përputhshme per Rescue SAM Aed

III.3.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këto pretendime të ankimesit sqarohet se:

- Në lidhje me letrën EKG nuk është bërë specifikim për ndonjë lloj letrë përveçse për letrë EKG. Thjesht është përcaktuar që letra EKG të jetë e përshtatshme për defimonitor EVO pasi të këtij lloji janë defimonitorët tanë në të cilët letra EKG do të përdoret. Ne si autoritet kontraktor nuk mund të vendosim togfjalëshin ose ekuivalent me të pasi në këtë mënyrë nuk do ti përshtatej pajisjeve që ne kemi dhe do të ishte e papërdorshme. Duke qenë se nëpërmjet EKG bëhet diagnostikimi i menjëhershëmi sëmundjeve vdekjeprurëse si infarkti i miokardit nuk mund të rezikojmë që letra të mos përshtatet me pajisjet mjekësore që ne kemi në pronësi dhe funksionim si AK.
- Në lidhje me ngjitset për elektrodën nuk është bërë ndonjë specifikim për ndonjë lloj tjetër ngjitseje por thjesht është përcaktuar që të jetë e përshtatshme për defimonitor EVO pasi të këtij lloji janë defimonitorët tanë në të cilët do të përdoren ngjitset për elektrodën. Ne si autoritet kontraktor nuk mund të vendosim togfjalëshin ose ekuivalent me të pasi në këtë mënyrë nuk do ti përshtatej pajisjeve që ne kemi dhe do të ishte e papërdorshme. Duke qenë se nëpërmjet EKG dhe elektrodave bëhet diagnostikimi i menjëhershëmi sëmundjeve vdekjeprurëse si infarkti i miokardit nuk mund të rezikojmë që ngjitset për elektrodën dhe letra të mos përshtatet me pajisjet mjekësore që ne kemi në pronësi dhe funksionim si AK.
- Në lidhje me pjastrat pediatrike nuk është bërë specifikim për ndonjë lloj tjetër pjastre por thjesht është përcaktuar që të jetë jetë e përshtatshme për defimonitor EVO dhe e përshtatshme për Rescue Sam Aed pasi të këtij lloji janë pajisjet tona në të cilat do të përdoren piastrat. Ne si autoritet kontraktor nuk mund të vendosim togfjalëshin ose ekuivalent me të pasi në këtë mënyrë nuk do ti përshtatej pajisjeve që ne kemi dhe do të ishte e papërdorshme. Piastrat pediatrike duhet të kryejnë funksionin e defibrilimit dhe të pacemaker njëpërdorimshme adezive dhe me

diagrampër vendosje të qartë. Këto piastra përdoren në rast të arrestit kardiak pra është trajtimi specifik i vetëm për shpëtimin e jetës prandaj duhet të jetë origjinal të përputhshme njëqind për qind.

- Në lidhje me pjastrat adulte nuk është bërë specifikim për ndonjë lloj tjetër piastre por thjesht është përcaktuar që të jetë jetë e përshtatshme për defimonitor EVO dhe e përshtatshme për Rescue Sam Aed pasi të këtij lloji janë pajisjet tona në të cilat do të përdoren pjastrat. Ne si autoritet kontraktor nuk mund të vendosim togfjalëshin ose ekuivalent me të pasi në këtë mënyrë nuk do ti përshtatej pajisjeve që ne kemi dhe do të ishte e papërdorshme. Piastrat pediatrike duhet të kryejnë funksionin e defibrimit dhe të pacemaker njëpërdorimshme adezive dhe me diagrampër vendosje të qartë. Këto piastra përdoren në rast të arrestit kardiak pra është trajtimi specifik i vetëm për shpëtimin e jetës prandaj duhet të jetë origjinal të përputhshme njëqind për qind.

III.3.3. Në nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 5 “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
3. “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar”:
 - a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
 - b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
 - c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj62.
5. “Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

III.3.4. Referuar sa më sipër, KPP konstaton se në shtojcën e datës 08.11.2017, autoriteti kontraktor nuk ka bërë ndryshime thelbësore të specifikimeve teknike të mallrave por thjesht ka detajuar dhe përshkruar karakteristikat që duhet të përmbushin këto mallra në momentin e dorëzimit të tyre gjë të

cilën nuk e kishte bërë në dokumentat fillestare të procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se në specifikimet teknike të mësipërme nuk është parashikuar asnjë specifikë diskriminuese. Autoriteti kontraktor ka të drejtë dhe detyrim njëherazi për të qënë sa më i qartë sa më konkret në përshkrimin e detajuar të specifikave që duhet të përmbushë malli objekt prokurimi. Lidhur me pretendimin e ankimesit për vendosjen e togfjalësisht ekuivalent gjykon se për artikujt e sipërcituar është e pamundur të vendoset togfjalëshi ekuivalent pasi argumentat e autoritetit kontraktor se pajset ekzistuese nuk i përshtaten lloje të tjera të letrave, pajstrave apo ngjitseve është tërësisht i arsyetuar. Gjithashtu nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP rezulton se modifikimet e specifikimeve teknike me anë të shtojcës së datës 08.11.2017 janë bërë nga autoriteti kontraktor në përgjigje të kërkesave të operatorëve ekonomikë për sqarime më të hollësishme lidhur me specifikimet teknike. Komisioni gjykon se modifikimi i bërë nga autoriteti kontraktor nuk sjell asnjë ndryshim thelbësor dhe nuk ndikon në uljen apo kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimmuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimeusit se artikulli “Nr.38 Rregullues fluksi plastik i graduar është shtuar pjesa i graduar kjo ndryshon llojin duke rritur të dhenat e specifikimeve teknike. Nr.42. Paketë dezinfektimi me dezinfektantë për plagë: a) Betatide, b) Ujë i oksigjenuar. Në rastin konkret ky zë është ndryshuar tërësisht i cili sjell ndryshim cilësor dhe sasior të artikullit Betadina. Në këtë paketë është shtuar zëri betadinë nga 1000 shishe në 10.000. Në listën e mëparshme nuk ka ekzistuar kërkesa për ujë të oksigjenuar dhe ky zë është shtuar në pjesën e paketës gjë që sjell edhe 10,000 shishe shtesë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

Ishte

Rregullues fluksi



Paketë dezinfektimi me dezinfektantë për plagë

Bëhet:

Bëhet:

Rregullues fluksi plastik i graduar



Paketë dezinfektimi me dezinfektantë për plagë, e perbere nga:

a) Betadinë



b) Uje i oksigjenuar

III.4.1. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këto pretendime të ankimuesit sqarohet se:

- Në lidhje me rregulluesin e fluksit plastik të graduar nuk është ndryshuar lloji i tij thjesht është specifikuar që rregulluesi duhet të jetë i graduar dhe plastik për arsye se disa lloje në urgjencë duhen kontrolluar dozat e tyre në vazhdimësi për të garantuar parametrat jetësorë dhe duke mos pasur në dispozicion popma shiringa këtë gjë e garanton rregullatori i fluksit. Jo gjë nuk përbën ndryshim të llojit të rregulluesit të fluksit sikundër është pretenduar në ankesë.
- Në lidhje me paketën dizinfektuese për plagë betadina është përfshirë te paketa dezinfektuese së bashku me ujin e oksigjenuar. Pra është specifikuar konkretisht se cfarë do të përfshihet tek kjo paketë pasi është kërkuar sqarim nga operatorë të tjerë si rezulton në protokollin e AK. Betadina e ka të përcaktuar sasinë sic është vendosur në DST 1000 copë ndërsa uji i oksigjenuar po sic është parashikuar në DST është 10.000 copë dhe nuk ka asnjë zë apo sasi shtesë sikundër është pretenduar në ankesë. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndryshim sasior dhe as cilësor por vetëm me sqarim të përfshirjes së përbërësve të paketës dezinfektuese për lehtësi të operatorëve.

III.4.2. Referuar sa më sipër, KPP konstaton se në shtojcën e datës 08.11.2017 autoriteti kontraktor nuk ka bërë ndryshime thelbësore të specifikimeve teknike të mallrave por thjesht ka detajuar zërin dezinfektantë i cili është i parashikuar si në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” ashtu edhe në shtojcën 12 ‘Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit’, gjë të cilën nuk e kishte bërë në dokumentat fillestare të procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se në specifikimet teknike të mësipërme nuk është parashikuar asnjë specifikë diskriminuese. Autoriteti kontraktor ka të drejtë dhe detyrim njëherazi për të qënë sa më i qartë sa më konkret në përshkrimin e detajuar të specifikave që duhet të përmbushë malli objekt prokurimi. Komisioni gjykon se përcaktimi i llojit të dezinfektantëve duke mos ndryshuar në asnjë rast sasinë e tyre nuk sjell asnjë ndryshim në fondin limit të përllogaritur nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP rezulton se modifikimet e specifikimeve teknike me anë të shtojcës së datës 08.11.2017 janë bërë nga autoriteti kontraktor në përgjigje të kërkesave të operatorëve ekonomikë për sqarime më të hollësishme lidhur me specifikimet teknike.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë pjeserisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” sh.p.k lidhur me modifikimin e dokumentave për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-30565-10-20-2017 me objekt: “*Blerje Set të Urgjencës Mjeksores*”, me fond limit 39,644,828.00 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 21.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjeksores.
2. Të mos pranojë pretendimin e ankimesit “Almedical” shpk mbi anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Almedical” sh.p.k
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1736 Protokoli, Datë 20.11.2017

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Public Health Sector

Kryetar
Evis Shurdha